



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE
TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 9784/1 prot.

Tiranë, më 31.12.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012.

SHOQËRISË “FAFA KONSTRUKSION” SH.P.K
Bulevardi Blu, Zona kadastrale Nr. 8320, Nr. Pasurie 1/138-ND, Kamëz, Tiranë

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “FAFA” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj, Derjan”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 5513, datë 13.12.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 9784 Prot., datë 16.12.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin “Zall Gjoçaj, Derjan”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi në objekt nuk zhvillohet aktivitet minerar prej më shumë se një viti.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin "Zall Gjoçaj, Derjan", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1596, datë 19.11.2012, për mineralin Krom, në objektin "Zall Gjoçaj, Derjan", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

CENO KLOSI

